



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	03
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	06-02/1986/20
Data Datum Date	30.09.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1., nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5., nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.09.2020, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-1592/20, për zyrtarin e lartë publik z. Milazim Gjocaj, Drejtor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve në Ministrinë e Shëndetësisë, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia), rastin hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Milazim Gjocaj, Drejtor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve në Ministrinë e Shëndetësisë, e ka trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia, sipas denoncimit nga një raportues i jashtëm ka hapur për trajtim rastin e konfliktit të mundshëm të interesit, me pretendimin se z. Gjocaj duke qenë zyrtarë i lartë publik, respektivisht U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë njëkohësisht mban edhe pozitën e Dekanit në kolegjin privat Alma Mater Europae Campus College "Rezonanca" (në vijim: kolegji "Rezonanca").

Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të paraqitura, Agjencia ka ndërmarrë veprimet e nevojshme duke kërkuar informacione nga institucionet përkatëse lidhur me pozita që z. Gjocaj mban në këto institucione.

Me këtë rast jemi njoftuar se z. Gjocaj është dorëhequr nga pozita e U.D. e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe se i njëjti tani ushtron funksionin e Drejtorit të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve në këtë institucion, ndërsa nga kolegji “Rezonanca” kemi pranuar konfirmimin se z. Gjocaj ushtron funksionin e Dekanit pran këtij kolegji.

Pas konfirmimit të këtyre informacioneve nga institucionet përkatëse, Agjencia sipas procedurës së paraparë në nenin 22, paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-12592/20, e ka njoftuar z. Gjocaj për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Gjocaj, i njëjti ka telefonuar Agjencinë kundër Korrupsionit, për tu njoftuar për situatën e konfliktit të interesit. Me këtë rast Agjencia e ka njoftuar atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik respektivisht Drejtor i Departamentit, nuk mundet që njëkohësisht të mbaj edhe pozitën e Dekanit si pozitë menaxhuese në kolegji, pasi që një gjë e tillë është e ndaluar me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.”

Me kërkesë të z. Gjocaj, Agjencia ka caktuar një takim me të, ku me qëllim të sqarimit të situatës së konfliktit të interesit të njëjtin e ka njoftuar sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit “zyrtar i lartë - nënkupton zyrtarët e lartë publik të përcaktuar sipas Ligjit përkatës për deklarin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë”, (neni 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3.).

Ndërsa Ligji Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar (në vijim: Ligji për Deklarimin e Pasurisë), Drejtorin e Departamentit në të gjitha institucionet publike e rendit në radhën e zyrtarëve të lartë publik (neni 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1., pika 1.1.11.), të cilët zyrtar sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit kanë kufizime për sa i përket ushtrimit të pozitave drejtuese në institucionet tjera.

Pas kësaj, z. Gjocaj është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka premtuar se brenda afatit do të ndërmarr veprimet e nevojshme në mënyrë që të shmang situatën e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare DPKI-06-1876/20 me dokumentet përcjellëse, në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë ka pezulluar pozitën e Dekanit në kolegjin “Rezonanca” për kohë të pacaktuar.

Me veprimet e ndërmarra nga z. Gjocaj, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip HAVOËLLI
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

